

SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT Nr. 22, Datë 24.09.2012 PËR "PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË TË TË DHËNAVE PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA SUBJEKTET PËRPUNUESE TË VOGLA", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR. 34, DATË 21.01.2013.

Shembulli i mëposhtëm është një rast hipotetik.

Kompania A punëson 5 operatorë me kontrata shërbimi jashtë orarit të punës të cilët punonin nga shtëpia duke iu ofruar këtë shërbim dhe Kompanisë B pa asnjë kontratë.

Ndërkohë në banesën e njërit prej punonjësve humbasin 2 laptopë të pakoduar me të dhëna personale të shumë personave.

Laptopët ishin të mbrojtur me fjalëkalim, por nuk ishin të koduar - gjë që bie në kundërshtim me politikën e sigurisë së informacionit të të dyja kompanive.

Kompania A gjendet në shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe në shkelje të politikës së saj të sigurisë të të dhënave personale duke lëshuar një laptop të pakoduar.

Kompania A nuk bënte kontrole të mjaftueshme në terren për të siguruar që politikën përkatëse të sigurisë të respektoheshin dhe të kuptoreshin drejtë nga stafi.

Kompania B gjendet në shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi nuk kishte nënshkruar një kontratë të rregullt me Kompaninë A për ofrimin e këtij shërbimi.

Duhet të theksojmë se vetëm fjalëkalimi në pajisjet portative, nuk është i mjaftueshëm për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale. Udhëzimi nr.22, i ndryshuar përcakton standarde themelore për sigurinë e të dhënave personale, ndër të tjera përfshin edhe analizën e rrishtit, sigurinë fizike dhe të ambientit, sigurinë llogjike të pajisjeve TIK si dhe informimin e punonjësve mbi rreziqet kryesore ndaj të cilave janë të ekspozuar. Të gjitha mjetet portative elektronike që përdoren si bartës të informacionit si USB, CD, laptopë etj, duhet të kodohen përpara se të largohen nga ambientet e subjektit përpunues.